



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR
Didaktikë e Gjuhës së Huaj 2

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione /20 seminare

Viti akademik: 2024-2025, Viti III / Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kursi synon t'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike për mësimdhënien efektive të gjuhës angleze në shkollën e mesme, në përputhje me moshën dhe nevojat e nxënësve. Ai fokusohet në zhvillimin e katër aftësive gjuhësore, mësimin e fjalorit dhe testimin, duke integruar metoda bashkëkohore dhe një qasje ndërvepruese ndaj procesit mësimor.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të njihen me teknika dhe metoda për mësimdhënien e fjalorit, gramatikës, shqiptimit dhe katër aftësive gjuhësore.
- 2.Të ndërtojnë objektiva mësimorë dhe plane mësimore të përshtatura sipas klasës.
- 3.Të përdorin strategji efektive për të nxitur të nxënit aktiv dhe për të menaxhuar klasën.
- 4.Të aftësohen në përzgjedhjen dhe përpunimin e materialeve mësimore.
- 5.Të analizojnë dhe reflektojnë mbi procesin mësimor për zhvillim profesional të mëtejshëm.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë parimet themelore të mësimdhënies së gjuhës së huaj, të përdorin teknika të përshtatshme për gramatikën, fjalorin dhe aftësitë gjuhësore, të hartojnë plane mësimore efektive, të menaxhojnë klasën me strategji adekuate dhe të reflektojnë profesionalisht mbi procesin e tyre të mësimdhënies.